



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ZËDHËNËSI

Tiranë, më 09 Janar, 2014

*Njoftim për Shtyp*

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI  
DY ISH-DREJTORËT E PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, DISA ZYRTARË TË TJERË DHE  
ISH-KRYETARIN E KOMUNËS MBROSTAR, FIER**

*- Abuzime dhe dëm ekonomik mbi 1.3 milionë euro -*

KLSH përfundoi në dhjetor 2013 auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK), Tiranë për periudhën 01.01.2012 deri 30.9.2013, me objekt “ Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar”. Nga auditimi rezultuan një sërë shkeljesh dhe parregullshmëri ligjore në fushën e prokurimeve publike, si më poshtë:

1-Në tenderin me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës Kavajë nga pusshpimet e Çermës loti III”, u konstatua se: nga amendimi i kontratës nr. 901/1, datë 05.4.2013 për lejimin e paradhënies në masën 10% të vlerës së kontratës (**90,000,000 lekë**) Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ”Alba Konstruksion & C.E.L.I. Cooperativa”, fitues i tenderit, është bërë në kundërshtim me nenin 10 të kontratës nr. 901, datë 05.4.2013, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013” dhe Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave, pika 147, në të cilët nuk është parashikuar dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies.

U konstatua se në kontratën nr. 901, datë 05.4.2013, është shtuar në nenin 10, shënim i shkrimi dore “< ose=10 %”, i cili është nënshkruar dhe vulosur nga ish Drejtori i Përgjithshëm i DPUK-së M. Ç., duke kryer në këtë mënyrë fallsifikim të dokumentit zyrtar dhe njëkohësisht duke urdhëruar likuidimin e firmës, në shumën **90,000,000 lekë** “paradhënie”. Veprimet e likuidimit të kësaj paradhënie, në kundërshtim me aktet e sipërcituara janë kryer nga M. S., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës, e komanduar vetëm për periudhën e kryerjes së likuidimit të paradhënies.

Duke qënë se shkeljet e konstatuara përbëjnë haptazi vepër penale, në zbatim të nenet 280 dhe 281 të Kodit të Procedurës Penale, KLSH ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të DPUK-së M. Ç. dhe ish-Përgjegjëses së Sektorit të Financës M.S., për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe veprën penale të “fallsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

2- Në tenderin me objekt “Furnizim me ujë i zonës së Kënetës, Durrës zona 8-14(shtesë kontrate), ku vlera e kontratës është **38,520,000 lekë** është konstatuar shmangie nga procedurat e prokurimit në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik, kreu II, pika 1/c e VKM nr.1, dt 10.1.2007, e cila ka çuar në mungesën e konkurrencës dhe lindjen e

pabarazisë së pjesëmarrësve në tender, në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, pasi nuk ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e procedurës së tenderimit “Negociim pa shpallje paraprake”. Në këto kushtë, bazuar në nenet 280 dhe 281 të të Kodit të Procedurës Penale, KLSH ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, në ngarkim të E. H., ish Drejtor i Përgjithshëm i DPUK-së, i cili, në ushtrim të detyrës ka lejuar shkeljen e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.

**3-Në tenderin me objekt “Rrjeti i ri i Kanalit të Ujrave të Zeza i fshatit Mbrostar-Ura faza e parë, Komuna Mbrostar, Fier” u konstatuan shkelje në procedurën e marrjes në dorëzim të veprës. Ky objekt është financuar nga buxheti i shtetit në vlerën **56,926,557 lekë** me TVSH dhe rezultoi të jetë marrë në dorëzim provizor nga ish Kryetari i Komunës V. B. në një kohë që objekti është jashtë funksionit. **Dëmi ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit nga mos funksionimi i këtij objekti është 56,926,557 lekë.** Në këto kushte, bazuar në nenet 280 dhe 281 të të Kodit të Procedurës Penale, KLSH ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për konsumimin e veprës penale shpërdorim detyre, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të: V. B, ish Kryetar i Komunës Mbrostar, T.N., në cilësinë e Kolaudatorit dhe A. K., në cilësinë e projektuesit.**

Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se ka punime të pakryera në vlerën **5,678,743 lekë** gjithsej, e cila përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit**, përkatësisht në tenderin me objekt “Kolektori i Ujrave të Ndotura, D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë” përfituar padrejtësisht në vlerën **4,464,793 lekë** nga sipërmarrësi i punimeve, dhe në tenderin “Ndërtim i kolektorit të ujrave të zeza Sarandë, lidhja IPUZ”, në vlerën **1,213,950 lekë**, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi përkatës i punimeve.

Nga auditimi, KLSH konstatoi se gjatë zbatimit të buxhetit të shtetit, Skema e Grandit Konkurrues nuk garanton konsultime me qarqet dhe nuk bazohet në kritere, të cilat kërkojnë një verifikim të pavarur të të dhënave të raportuara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV). Nga ana e DPUK-së nuk verifikohen nëse këto investime janë në përputhje me Strategjinë Ndërsëktoriale për Zhvillimin Rajonal. Shpërndarja gjeografike e projekteve mbulonte zona shumë të afërta me njëra tjetrën, duke krijuar nevojën e një masterplani. Skema, sikurse funksionon sot, është totalisht e pa monitoruar nga DPUK apo dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

DPUK nuk ka një database i cili të përmbajë çdo investim të kryer në infrastrukturën ujore, që në mënyrë kronologjike të japë një historik të detajuar mbi çdo financim dhe inventar fizik të këtyre investimeve apo projekteve. Ekzistenca e një database të tillë do t'i shërbente vetë DPUK-s për planifikimin real të çdo investimi duke shmangur dublime të investimeve, duke ju përjasur një strategji sektoriale afër nevojave reale të çdo qarku në Republikën e Shqipërisë.

Në këto kushte, KLSH ka rekomanduar që: DPUK në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, t'i propozojë Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve rishikimin e Vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve “Për përcaktimin e kritereve për ndarjen e fondit për Zhvillimin e Rajoneve” lidhur me vendosjen e kritereve më të qarta për alokimin e fondeve të investimeve dhe grandeve konkurruese si dhe aplikimin e tyre në mënyrë konsistente.